



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 15, dt. 31.10.2022

***MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË NIVELIN E PAGAVE TË FUNKSIONARËVE
TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS TË
KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022, SIPAS VKM-së nr.625 dt.28.09.2022***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177 dt. 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165 date 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 3 date 15.06.2022 “Mbi riorganizimin e strukturës organizative, klasifikimin nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”, si dhe VKM-së nr.625 dt.28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165 dt.02.03.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin në nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2022 sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Efektet financiare do të perballohen nga fondet e lira të pagave, krijuar si pasojë e vakancave, të miratuara me buxhetin e vitit 2022 dhe i shtrijnë efektet financiare duke filluar nga data 1 Tetor 2022

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut.

Kryetari i Këshillit të Qarkut
Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION
MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË NIVELIN E PAGAVE TË
FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË
ADMINISTRATËS TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022, SIPAS VKM-së
nr.625 dt.28.09.2022

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177 dt. 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165 date 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kuqijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 3 date 15.06.2022 “Mbi riorganizimin e strukturës organizative, klasifikimin nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”, si dhe VKM-së nr.625 dt.28.09.2022, Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165 dt.02.03.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i propozojmë Këshillit të Qarkut miratimin e nivelit të ri të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2022, sipas tabelës bashkëngjitur.

Miratimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë efekte financiare në rritje të fondit të pagës dhe sigurimeve shoqërore të miratuar për vitin 2022, pasi kjo rritje do të perballohet nga fondet e lira të pagave, krijuar si pasojë e vakancave, të miratuara me buxhetin e vitit 2022.

Sa më sipër paraqesim për miratim nivelin e ri të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar si dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2022 , ndryshuar bazuar në VKM-në nr.625 dt.28.09.2022.

Korçë, me 27.10.2022

Oljona Beqiraj
Përgjegjëse Finance

**STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS TË
KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022**

V.K.M.625 dt 28.09.2022 Për disa shtesa e ndryshime ne vendimin 165 dt. 02.03.2016 te Keshillit te Ministrave "Për grupimin e njësive të veteqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e të punonjësve administrative të njësive të qeverisjes vendore"

Nr.	Njësia strukturore	Nr puno-njësve	Niveli Lidhja 7	Paga Gr, sipas Kat.diplom	Paga e grupit	Vjetërsi 2%	Paga e pozicionit	Statusi I punonjesit
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	1/e				150000	Të zgjedhur
II	Zvendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	1/e				101650	Të zgjedhur
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	I-b	I	14000	2%	93000	I e emeruar K.Qarkut
IV	Kabineti I Kryetarit							
	Drejtor I kabinetit te kryetarit - Keshilltar juridik	1	I-b	1	14000	2%	105000	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar i maredhenieve me publikun dhe mediat	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	79000	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar per Projektet e Bashkimit European	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	85000	Pozicion pune me kontratë
	Zedhenes i zyres se Kryetarit dhe sherbime te tjera	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	57000	Pozicion pune me kontratë
V	Spektori i finances, zhvillimit ekonomik, sherbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit te territorit							
	Pergjegjes I Sektorit te Finances dhe Buxhetit	1	III-a/1	1	14000	2%	74700	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist i nivelit të lartë për Shërbimet, Burimet Njerezore dhe Emergjencat Civile	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist i nivelit të lartë për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist I nivelit te larte per programet e zhvillimit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist per Shendetsine dhe Ceshtjet sociale, arsimin dhe Kulturen	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Shofer autoveture I institucionit	1	P.19/20			1%	41700	Pozicion pune me kontratë
	Totali Administrata	13						

